



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr.Dok. 202001764/6

Tiranë 28 / 12 /2020

Lënda: Rekomandim lidhur me mundësinë e përfshirjes së ankuesit z.A.B në një nga programet sociale të strehimit.

Drejtuar : BASHKISË
Z.Kryetar

FIER

I nderuar Z.Kryetar,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, siç jeni në dijeni, ka paraqitur një ankesë shtetasi z.A.B banues në Drizë Fier, për mungesë strehimi që nga viti 1991 e deri më tani. Ai dhe familja e tij prej 7 anëtarësh jetojnë në qiell të hapur pa banesë. Z.B e ka adresuar shqetësimin e tij pranë Bashkisë Fier disa herë për të gjetur një zgjidhje si dhe pranë kryeplakut të fshatit por nuk ka marrë asnjë përgjigje për t'u pajisur me banesë apo për të përfutur nga ndonjë nga programet sociale të strehimit. Kushtet e vështira të tij dhe pamundësia e kanë bërë që këtë shqetësim ta adresojë edhe pranë Institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të tij të ligjshme në mënyrë që të marrë një përgjigje pozitive lidhur me shqetësimin jetik të familjes së tij.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike shqiptare, në përputhje me nenin 2 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", ka konstatuar se *rasti plotëson kushtet për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, pasi ankuesi është shtetas shqiptar, subjekti ndaj të cilit ai ankohet është organ i administratës publike, dhe objekti i ankesës është një pretendim për veprime të paligjshme i kësaj të fundit.*

Për sa më lart, bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/a , ka vendosur t'a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë një proces hetimi administrativ.

ANALIZA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT, KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për nevoja të shqyrtimit të kësaj ankese i jemi drejtuar bashkisë Fier me shkresën nr.prot K3/A27-2, datë 15.06.2020, K3/A27-4, datë 02.09.2020, K3/A27-5, datë 23.11.2020, në të cilat ju kemi kërkuar të na dërgoni një informacion nëse qëndrojnë pretendimet e ankuesit, çdo

Iloj informacioni që ka të bëjë me këtë çështje si dhe veprimet që do të ndërmerri për zgjidhjen e problematikës jetike të tij duke ju kërkuar që ankesa/kërkesa e tij të trajtohet me prioritet pasi është rast i vështirë human me fëmijë të mitur.

Në asnjë rast kërkesave të përsëritura të institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje, nuk i është kthyer përgjigje nga ana Juaj.

Kështu, ju nuk keni paraqitur shpjegimet e sqarimet tuaja të argumentuara, lidhur me veprimet apo mosveprimet e bashkisë ndaj qytetarëve në këto raste të vështira.

Në lidhje me këtë çështje fillimisht gjejmë rastin t'ju sjellim në vëmendje parashikimet e nenit 22/1 të ligjit nr. Nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar:

Neni 22/1

Sanksionet për mos bashkëpunimin me Avokatin e Popullit Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.

Lidhur me trajtimin e problemit të strehimit të ankuesit, referuar misionit të bashkisë si organ i pushtetit vendor që siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve¹, vlerësojmë se ka vend për përmirësim në qasjen që bashkia si organ kyç i pushtetit vendor duhet të ketë ndaj qytetarëve, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre.

Nga ana tjetër, vlerësojmë të sjellim në vëmendje faktin se organet e pushtetit vendor, si organet qeverisëse të cilat janë më afër qytetarit se çdo organ tjetër, duhet të kujdesen që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet në mënyrë arbitrare dhe jo proporcionale asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta. Organi i pushtetit vendor duhet të reflektojë një sjellje e cila të mos jetë përjashtuese apo diskriminuese kundrejt grupimeve të caktuara të qytetarëve të cilët kanë të drejta të barabarta pavarësisht gjendjes apo përkatësisë ekonomike, sociale, kulturore, etnike, arsimore, etj. Gjithashtu të mbështesë dhe të vërtetojë qasjen apo sjelljen që ka pasur dhe ka bashkia ndaj qytetarëve në këto raste të vështira humane, e për më tepër arsyen tjetër humane ku pjestarë të familjes janë edhe të mitur.

Qytetari nuk është dëgjuar e as orientuar nga personat përgjegjës për përfitimin qoftë edhe nga programet sociale të strehimit. Cilado që të ketë qenë forma e adresimit ndaj qytetarit, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se ndodhemi para rastit të refuzimit të ofrimit të shërbimit publik ndaj qytetarit, në kundërshtim të hapur me parimet e ofrimit dhe sigurimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve, si parimi i ligjshmërisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, transparencës e proporcionalitetit, referuar ligjit nr. 13/2016 por edhe Kodit të Procedurave Administrative. Bashkitë si ofruese të shërbimeve duhet të jenë më fleksibël për të dëgjuar e adresuar drejt qytetarët si dhe adresuar drejt përgjegjësinë tek personat përkatës.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua në këtë rekomandim, vlerësojmë se sjellja e Bashkisë Fier përkundrejt ankuesit por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për qeverisje dhe garanci social ekonomike për qytetarët e grupet në nevojë dhe aq më pak standardin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve, siç është e drejta për strehim. Për të adresuar problemetikën e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, aq më tepër institucionet e pushtetit vendor si institucione, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve

¹ Sipas nenit 3 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 59, pika 1 gërma “b” lidhur me objektivat social parashikohet shprehimisht se: *“Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim”*. Nga ana tjetër sipas nenit 38 të Kushtetutës: *“Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin e tij si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit”*, e drejtë kjo që kondicionohet me faktin se duhet të kesh një banesë për strehim.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua në këtë rekomandim, vlerësojmë se sjellja e Bashkisë Fier përkundrejt ankuesit por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e nevojshëm për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve, dhe aq më pak standardin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve, siç është e drejta për strehim.

Sa më lart, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*, dhe neni 22/1 në të cilin thuhet se: *Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil,*

REKOMANDOJMË:

- Bashkia Fier të marrë masa për të analizuar situatën e ankues/kërkuesit duke e përfshirë atë në një nga programet sociale të strehimit, sipas ligjit nr. Nr. 22/2018 *“Për strehimin social”* dhe akteve nënligjore përkatëse;
- Kryerjen e një hetimi administrativ për të përcaktuar masën e përgjegjësisë në nivel hierarkik ndërmjet strukturave të institucionit lidhur dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësve/punonjësve që kanë refuzuar bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, duke mos reaguuar ndaj kërkesave të këtij të fundit.
- Bashkia Fier gjatë ushtrimit të veprimtarisë në drejtim të ofrimit/orientimit të shërbimeve publike për qytetarët të jetë më fleksibël duke adresuar drejt qytetarët, si dhe duke respektuar të drejtat e tyre.

Lutemi që të njoftohemi brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi për masat apo veprimet e ndërmarra nga Bashkia Fier.

Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Prof.As.Dr.Erjona BANA(CANAJ)